



**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**

**Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional**

**STANDARDI I PROFESIONIT**

**BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL TË PUNËS SOCIALE**

**Sektori: Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale**

**Prill, 2016**

**Ekipi i zhvillimit:**

**Koordinator i ekipit:** Qazim Gashi

**Përbërja e ekipit:**

Qazim Gashi-Anëtar i KPSHSF

Genc Ymerhalili-Anëtar i KPSHSF-së

Selvete Sadiku-Anëtar i KPSHF-së

Xhemajl Dugolli-Drejtore i ISSH-së

Myrvete Verbaj-Anëtar i KPSHSF-se

**Kodi profesionit:** 3412

**Data e aprovimit:**

**Valide:** Për periudhë 5 vjeçare

Ky standard i profilit është zhvilluar me përkrahje financiare nga Projekti “Mbështetje për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në forcimin e mekanizmave për implementimin e decentralizimit të shërbimeve sociale”, financuar nga BE

## **Profesioni: Bashkëpunëtorët profesional të punës sociale**

### **Përshkrimi i profesionit**

Bashkëpunëtorët profesional të punës sociale- karakterizohen me ofrimin e shërbimeve të personave dhe kategorive të ndryshme në nevojë.

Ai/ajo ofron përkujdesje për shëndetin e klientit duke filluar me vlerësimin e gjendjes shëndetësore të klientit, përgatitjen e planit të veprimit rreth nevojave të tij/saj si dhe monitorimin e gjendjes shëndetësore dhe ndërmarrjen e veprimeve të duhura sipas nevojave të klientit.

Përpos kujdesit shëndetësor, ai/ajo përkujdeset për nevojat ditore të klientit. Këto aktivitete i realizon duke ofruar përkujdesje klientit në gatimin e ushqimit, ofrimin e përkujdesjes së klientit në mirëmbajtjen e higjienës dhe mirëmbajtjes së shtëpisë si dhe në blerjen e produkteve për klientin

Për klientin e tij/saj përkujdeset rreth shërbimeve të transportit dhe lëvizshmërisë. Atë e bën duke ofruar mbështetje në lëvizshmëri të klientit nëpërmjet transportit me makinë dhe me karrocë për personat me apo pa aftësi të kufizuara.

Poashtu përkujdeset për higjienën e klientit dhe ambientit që e rrethon. Ai/ajo angazhohet me ofrimin e përkujdesje për higjienë personale të klientit, kujdesin e ofruar për veshjen apo zhveshjen e kandidatit si dhe përkujdesin e ofruar rreth nevojave shqisore të klientit.

Ndërsa sa i përket aktiviteteve sociale të klientit, ai/ajo organizon dhe menaxhon aktivitetet sociale për ata. Zakonisht e bënë duke organizuar aktivitete dhe lidhje shoqërore me klientin si dhe përgatitjen dhe bashkërendimin e aktiviteteve për grupe individësh

Janë të shumta vendet që këta bashkëpunëtorë profesional mund të punojnë, sikurse në shtëpi të pleqve, qendra të ndryshme rehabilitimi, shtëpi private të klientit si dhe në institucione të tjera relevante dhe publike.

**Profesioni: Bashkëpunëtorët profesional të punës sociale**

Nr.	Funksioni	Aktivitetet kyçe
1	Përgatitet për vendin e punës	Ky funksion ka të bëjë me përgatitjen e zakonshme të pajisjeve dhe mjeteve të punës, kontrollimin e bazës së të dhënave të klientëve, organizmin e punës, prioritizimi i aktiviteteve që kanë një rëndësi të madhe për atë ditë si dhe kontaktimi me stafin.
2	Ofron përkujdesje për shëndetin e klientit	Ky funksion ka të bëjë me vlerësimin e gjendjes shëndetësore të klientit, përgatitjen e planit të veprimit rreth nevojave të tij/saj si dhe monitorimin e gjendjes shëndetësore dhe ndërmarrjen e veprimeve të duhura sipas nevojave të klientit
3	Përkujdeset për nevojat ditore të klientit	Ky funksion ka të bëjë me ofrimin e përkujdesjes së klientit në gatimin e ushqimit, ofrimin e përkujdesjes së klientit në mirëmbajtjen e higjienës dhe mirëmbajtjes së shtëpisë si dhe në blerjen e produkteve për klientin
4	Përkujdeset rreth shërbimeve të transportit dhe lëvizshmërisë së klientit	Ky funksion ka të bëjë me ofrimin e mbështetjes në lëvizshmëri të klientit nëpërmjet transportit me makinë dhe me karrocë për personat me apo pa aftësi të kufizuara
5	Përkujdeset për higjienën e klientit dhe ambientit që e rrethon	Ky funksion ka të bëjë me ofrimin e përkujdesje për higjienë personale të klientit, kujdesin e ofruar për veshjen apo zhveshjen e kandidatit si dhe përkujdesin e ofruar rreth nevojave shqisore të klientit.
6	Organizon dhe menaxhon aktivitetet sociale për klientët.	Ky funksion ka të bëjë me organizimin e aktiviteteve dhe lidhjeve shoqërore me klientin si dhe përgatitjen dhe bashkërendimin e aktiviteteve për grupe individësh
7	Siguron mbrojtje në punë dhe ruajtje të mjedisit	Ky funksion ka të bëjë me: mirëmbajtjen e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, evitimin e rreziqeve, shëndetit dhe sigurisë, përdorimin e pajisjeve, veglave dhe materialeve në mënyrë të sigurt, mirëmbajtjen e pastërtisë në hapësirën e punës.

## Funksioni 1: Përgatitet për vendin e punës

Ky funksion ka të bëjë me përgatitjen e zakonshme të pajisjeve dhe mjeteve të punës, kontrollimin e bazës së të dhënave të klientëve, organizimin e punës, prioritizimin e aktiviteteve që kanë një rëndësi të madhe për atë ditë si dhe kontaktimi me stafin.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e kërkuara për kryerjen e funksionit	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe
Kontrollon bazën e të dhënave të klientëve	Kontrollon databazën; Identifikon klientët e ditës.	Materialet që përdoren; Veglat dhe pajisjet; Rregullat e mbrojtjes në punë; Komunikimin e duhur me klientin.	Kontrolluese; Organizative; Përdorimi i pajisjeve; Komunikimi; Sjellje me klientë; Punë ekipore; Vlerësuese; Aftësi për të punuar në kushte të vështira; Komunikimi me ekipin; Koordinimi i veprimeve sipas nevojës;	I përshtatshëm për punë ekipore; Komunikativ; Fleksibil; Tolerant; I arsyeshëm; I vetëdijshëm për punën që kryen; Organizative; Negocimi
Organizon punën për përkujdesje ndaj klientit	Përcakton prioritetet; Bën planin e veprimit; Realizon planin e përkujdesit të klientit.			
Përgatit pajisjet dhe mjeteve të punës për përkujdesje ndaj klientit	Përcakton nevojën për pajisje; Përgatit pajisjet sipas nevojës së klientëve			

### Kushtet e realizimit të funksionit:

Për të kryer këtë funksion, kandidati duhet të ketë në dispozicion dhe të përdorë këto mjete: manualët për përdorim të pajisjeve, kompjuterin, mjetet e komunikimit, qasje në internet, si dhe në progamet aplikative.

### Kërkesat e Vlerësimit:

Test me shkrim dhe pyetje – përgjigje për të demonstruar njohuritë dhe aftësitë bazë mbi organizimin e vendit të punës.

Kandidati i nënshtrohet provimeve praktike në një situatë reale të punës në punëtori. Vëzhgim i kandidatit nëpërmjet demonstrimit praktik të përdorimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve të punës, komunikimit me shkrim dhe me gojë me klientët dhe përdorimit të mjeteve të komunikimit

## Funksioni 2: Ofron përkujdesje për shëndetin e klientit

Ky funksion ka të bëjë me vlerësimin e gjendjes shëndetësore të klientit, përgatitjen e planit të veprimit rreth nevojave të tij/saj si dhe monitorimin e gjendjes shëndetësore dhe ndërmarrjen e veprimeve të duhura sipas nevojave të klientit

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e kërkuara për kryerjen e funksionit	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe
Identifikon gjendjen shëndetësore të klientit	Identifikon gjendjen e përgjithshme të klientit; Identifikon funksionet natyrale të trupit; Identifikon simptomat e veçanta të klientit; Identifikon gjendjen psikike të klientit; Identifikon gjendjen sociale të klientit; Identifikon gjendjen e pjesëve të ndryshme të trupit.	<u>Standardet për mbrojtjen e personave të moshuar;</u> <u>Standardet profesionale dhe të strukturuar;</u> <u>Standardet për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara.</u> Ndërhyrja në krizë; Ndihmën ndaj të Pastrehëve; Bujtinat dhe kujdesin paliativ;	Identifikimi të gjendjeve të ndryshme të klientit; Planifikimi të nevojave të klientit; Organizative; Monitorimi; Kontrolluese; ; Sjellje me klientë; Punë ekipore; Vlerësuese;	I përshtatshëm për punë ekipore; Komunikativ; I pavarur; Fleksibil; Tolerant; I arsyeshëm;
Përgatit planin e veprimit rreth nevojave të klientit	Identifikon problemet; Cakton prioritete; Ndërmerr veprimet e duhura sipas planit dhe; Evidenton punën e kryer ne raport.	Spitali / Punët Sociale mjekësore; Strehimin; Shërbimet në shtëpi; Terapinë e Shëndetit Mendor; Edukimin e prindërve;	Aftësi për të punuar në kushte të vështira; Komunikimi me ekipin; Koordinimi i veprimeve sipas nevojës; Aftësi për zgjidhjen e shpejtë dhe të drejtë të situatave konkrete.	I vetëdijshëm për punën që kryen; Njohja e gjuhëve të huaja; Organizative; Negocimi.
Kryen monitorimin e gjendjes shëndetësore dhe ndërmerr veprimet	Kryen furnizimin e rregullt me barna; I bën të ditur orarin e terapisë	Mirëqenien publike; Punën Sociale rurale;		

e duhura sipas nevojave të klientit	dhe jep terapinë me kohë sipas nevojës; Mat tensionin e klientit; Organizon vizitat shëndetësore tek specialistët përkatës.			
-------------------------------------	---	--	--	--

**Kushtet e realizimit të funksionit:**

Për të kryer këtë funksion, kandidati duhet të ketë në dispozicion dhe të përdorë këto mjete: uniformën, mjetet përkatëse për dhënien e terapisë, matjen e tensionit, manualet për përdorim të pajisjeve, kompjuterin, mjetet e komunikimit, qasje në internet, si dhe në programet aplikative.

**Kërkesat e Vlerësimit:**

Test me shkrim dhe pyetje – përgjigje për të demonstruar njohuritë dhe aftësitë bazë mbi ofrimin e përkujdesjes për shëndetin e klientit

Kandidati i nënshtrohet provimeve praktike në një situatë reale të punës në punëtori. Vëzhgim i kandidatit nëpërmjet demonstrimit praktik të përgatitjes së klientit për ofrimin e përkujdesjes për shëndetin e klientit dhe përdorimit të pajisjeve të punës.



### Funksioni 3: Përkujdeset për nevojat jetësore të klientit

Ky funksion ka të bëjë me ofrimin e përkujdesjes së klientit në gatimin e ushqimit, ofrimin e përkujdesjes së klientit në mirëmbajtjen e higjienës dhe mirëmbajtjes së shtëpisë si dhe në blerjen e produkteve për klientin

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e kërkuara për kryerjen e funksionit	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe
Ofron përkujdesje të klientit në gatimin e ushqimit	Vlerëson rastin; Parapërgatit ushqimin sipas rekomandimeve të mjekut; Servon ushqimin; Pastron enët.	Llojet kryesore të ushqimeve me prejardhje bimore Llojet kryesore të ushqimeve me prejardhje shtazore Llojet kryesore të ushqimeve me prejardhje artificiale		I përshtatshëm për punë ekipore;
Ofron përkujdesje të klientit në mirëmbajtje të higjienës dhe mirëmbajtjes së shtëpisë	Kryen pastrimin dhe mirëmbajtjen e kuzhinës, Kryen klasifikimin dhe hedhjen e mbeturinave; Kryen pastrimin e lavamanit, vaskës dhe guacës në banjo; Kryen pastrimin dhe tharjen e dyshemesë në banjo; Kryen thithjen e pluhurit nga qilimat në dhomën e ndenjës dhe të gjumit; Kryen pastrimin e pluhurit nga sipërfaqet e drunjëta dhe mirëmbajtjen e tyre; Kryen ndërrimin e çarçafëve dhe këllëfëve në dhomën e gjumit; Kryen klasifikimin e rrobave për larje sipas ngjyrës dhe tiketës	Procedurat e pastrimit dhe higjienizimit të kuzhinës Procedurat e pastrimit dhe higjienizimit të banjës Procedurat e pastrimit dhe higjienizimit të dhomës së gjumit; Pajisjet dhe materialet themelore për mirëmbajtje shtëpiake; Masat e sigurisë gjatë punës me mjete për mirëmbajtje Procedurat e pastrimit dhe higjienizimit të dhomës së ndenjës Procedurat e pastrimit dhe higjienizimit të dyshemesë Kujdesi ndaj kafshëve	Analitike; Kreative; Përdorimi i pajisjeve; Koordinimi i veprimeve sipas nevojës; Aftësi për zgjidhjen e shpejtë dhe të drejtë të situatave konkrete; Krahasimi të vlerave;	I pavarur; Komunikativ; Fleksibil; Tolerant; I arsyeshëm; I vetëdijshëm për punën që kryen; Organizative; Negocimi.

	udhëzuese; Kryen larjen e rrobave sipas udhëzimeve në rrobalarëse; Kryen tharjen e rrobave të lara; Kryen hekurosjen e rrobave të thara; Kryen mirëmbajtjen e kafshëve shtëpiake.	shtëpiake të klientit Procedura e mirëmbajtjes së rrobave <u>Standardet për mbrojtjen e personave të moshuar;</u> <u>Standardet profesionale dhe të strukturuar;</u> <u>Standardet për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara.</u>		
Ofron përkujdesje të klientit duke bërë blerje të produkteve	Vlerëson nevojën e klientit; Kryen blerjen sipas kërkesave të tij; Ofron mbështetje në bartjen e blerjeve të bëra.			

**Kushtet e realizimit të funksionit:**

Për të kryer këtë funksion, kandidati duhet të ketë në dispozicion dhe të përdorë këto mjete: manualët për përdorim të pajisjeve, kompjuterin, mjetet e komunikimit, qasje në internet, si dhe në progamet aplikative.

**Kërkesat e Vlerësimit:**

Test me shkrim dhe pyetje – përgjigje për të demonstruar njohuritë dhe aftësitë bazë mbi kryerjen e shërbimeve sociale në ofrimin e përkujdesjes për nevojat jetësore të klientit

Kandidati i nënshtrohet provimeve praktike në një situatë reale të punës në punëtori. Vëzhgim i kandidatit nëpërmjet demonstrimit praktik të ofrimin e përkujdesjes për nevojat jetësore të klientit, dhe përdorimit të pajisjeve të punës.

#### Funksioni 4: Përkujdeset rreth shërbimeve të transportit dhe lëvizshmërisë së klientit

Ky funksion ka të bëjë me ofrimin e mbështetjes në lëvizshmëri të klientit nëpërmjet transportit me makinë dhe me karrocë për personat me apo pa aftësi të kufizuara

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e kërkuara për kryerjen e funksionit	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe
Ofron mbështetje/ndihmë në lëvizshmëri nëpërmjet transportit me makinë (për persona me apo pa aftësi të kufizuara)	Vlerëson rastin; Cakton nevojat; Ofron shërbimin e transportit me makinë; Dokumenton aktivitetin e realizuar.	<u>Standardet për mbrojtjen e personave të moshuar;</u> <u>Standardet profesionale dhe të strukturuar;</u> <u>Standardet për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara.</u> Ndihmën ndaj të Pastrehëve;	Përdorimi i pajisjeve; Koordinimi i veprimeve sipas nevojës; Aftësi për zgjidhjen e shpejtë dhe të drejtë të situatave konkrete; Krahasimi të vlerave; Qasje pozitive në dukjen e klientit.	I përshtatshëm për punë ekipore; I pavarur; Komunikativ; Fleksibil; Tolerant; I arsyeshëm; I vetëdijshëm për punën që kryen; Organizativ; Negocimi.
Ofron mbështetje/ndihmë në lëvizshmëri nëpërmjet transportit me karrocë (për persona me apo pa aftësi të kufizuara)	Vlerëson rastin; Cakton nevojat; Ofron shërbimin e transportit me karrocë; Dokumenton aktivitetin e realizuar.			

#### Kushtet e realizimit të funksionit:

Për të kryer këtë funksion, kandidati duhet të ketë në dispozicion dhe të përdorë këto mjete: manualët për përdorim të pajisjeve, kompjuterin, pajisjet ortopedike që mundësojnë lëvizshmërinë, qasje në internet, si dhe në programet aplikative.

**Kërkesat e Vlerësimit:**

Test me shkrim dhe pyetje – përgjigje për të demonstruar njohuritë dhe aftësitë bazë mbi kryerjen e përkujdesit rreth shërbimeve të transportit dhe lëvizshmërisë së klientit

Kandidati i nënshtrohet provimeve praktike në një situatë reale të punës në punëtori. Vëzhgim i kandidatit nëpërmjet demonstrimit praktik të përgatitjes së ambientit për përkujdesin rreth shërbimeve të transportit dhe lëvizshmërisë së klientit si dhe përdorimit të pajisjeve të punës.

## Funksioni 5: Përkujdeset për higjienën e klientit dhe ambientit që e rrethon

Ky funksion ka të bëjë me ofrimin e përkujdesje për higjienë personale të klientit, kujdesin e ofruar për veshjen apo zhveshjen e kandidatit si dhe përkujdesin e ofruar rreth nevojave shqisore të klientit.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e kërkuara për kryerjen e funksionit	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe
Ofron përkujdesje për higjienë personale	<p>Planifikon kujdesin;</p> <p>Përzgjedh pajisjet e duhura për përkujdesje të higjienës personale;</p> <p>Bën ndërrimin e pampersave të klientëve, si dhe i përgatitë për gjumë në mbrëmje;</p> <p>Pastron këmbët;</p> <p>Rregullon shtratin;</p> <p>Kryen larjen dhe kujdesin për lëkurën;</p> <p>Kryen pastrimin e gojës dhe dhëmbëve;</p> <p>Kryen pastrimin special të gojës;</p> <p>Kryen pastrimin e flokëve dhe krehjen e klientit;</p> <p>Kryen rruarjen e klientit.</p>	<p>Gjendjen psikike të klientit;</p> <p>Përparësinë e kryerjes së procesit të higjienës personale;</p> <p>Higjienën personale të klientit;</p> <p>Higjienën personale të personelit shëndetësor;</p> <p>Mënyrat e larjes së pjesëve të trupit;</p> <p>Mirëmbajtja e hapësirave në shtëpi;</p> <p><u>Standardet për mbrojtjen e personave të moshuar;</u></p> <p><u>Standardet profesionale dhe të strukturuar;</u></p> <p><u>Standardet për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara.</u></p>	<p>Pastrimi të klientit;</p> <p>Pastrimi dhe higjienizimi i hapësirave në shtëpi;</p> <p>Veshjen dhe zhveshjen e klientit;</p> <p>Mirëmbajtja e rrobave;</p> <p>Përdorimi i pajisjeve;</p> <p>Sjellje me klientë;</p> <p>Komunikimi me klientin;</p> <p>Koordinimi i veprimeve sipas nevojës;</p> <p>Aftësi për zgjidhjen e shpejtë dhe të drejtë të situatave konkrete;</p> <p>Krahasimi të vlerave;</p> <p>Qasje pozitive në dukjen e klientit.</p>	<p>I përshtatshëm për punë ekipore;</p> <p>I pavarur;</p> <p>Komunikativ;</p> <p>Fleksibil;</p> <p>Tolerant;</p> <p>I arsyeshëm;</p> <p>I vetëdijshtëm për punën që kryen;</p> <p>Organizative;</p> <p>Negocimi.</p>
Kujdeset për veshmbathjen /zhveshje	<p>Vesh dhe zhvesh klientin;</p> <p>Ndërron pozicionin në shtrat të klientit.</p> <p>Bën pastrimin dhe mirëmbajtjen</p>	<p>Ndihmën ndaj të Pastrehëve</p>		

	e rrobave			
Ofron mbështetje rreth nevojave shqisore.	Mirëmban pajisjet e shikimit të klientit; Mirëmban pajisjet e dëgjimit			

**Kushtet e realizimit të funksionit:**

Për të kryer këtë funksion, kandidati duhet të ketë në dispozicion dhe të përdorë këto mjete: uniformën, sapunin, rreckë për larjen dhe peshqirët, gërhërë thënjësh, legen që përdoret për larje, ujë në temperaturën e dëshirueshme për klientin, manualet për përdorim të pajisjeve, dhe pajisjet tjera relevante.

**Kërkesat e Vlerësimit:**

Test me shkrim dhe pyetje – përgjigje për të demonstruar njohuritë dhe aftësitë bazë mbi ofrimin e përkujdesit për higjienën e klientit dhe ambientit që e rrethon.

Kandidati i nënshtrohet provimeve praktike në një situatë reale të punës në punëtori. Vëzhgim i kandidatit nëpërmjet demonstrimit praktik të përkujdesit për higjienën e klientit dhe ambientit që e rrethon dhe përdorimit të pajisjeve të punës.

## Funksioni 6: Organizon dhe menaxhon aktivitetet sociale për klientët

Ky funksion ka të bëjë me organizimin e aktiviteteve dhe lidhjeve shoqërore me klientin si dhe përgatitjen dhe bashkërendimin e aktiviteteve për grupe individësh

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e kërkuara për kryerjen e funksionit	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe
Organizon aktivitete dhe lidhje shoqërore	Organizon kontakte me familjen dhe shokët; Organizon vizita në shfaqje kulturore dhe ndeja të karakterit shoqëror; Blen shtypin e përditshëm dhe literaturës sipas preferencave të klienti. Organizon aktivitete komunikimi (telefon, me shkrim).	Llojet e aktiviteteve shoqërore; Aktivitetet rekreative; <u>Standardet për mbrojtjen e personave të moshuar;</u> <u>Standardet profesionale dhe të strukturuar;</u> <u>Standardet për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara.</u>	Organizative; Hulumtuese; Kontrolluese; Llogaritëse; Sjellje me klientë; Punë ekipore; Vlerësuese; Aftësi për të punuar në kushte të vështira; Komunikimi me ekipin;	I përshtatshëm për punë ekipore; Komunikativ; I pavarur; Fleksibil; Tolerant; I arsyeshëm; I vetëdijshëm për punën që kryen; Njohja e gjuhëve të huaja; Organizative; Negocimi.
Përgatit dhe bashkërendon aktivitetet për grupe individësh	Përgatit dhe bashkërendon aktivitetet për fëmijë; Përgatit dhe bashkërendon aktivitetet për të moshuar; Përgatit dhe bashkërendon aktivitetet për njerëz me aftësi të kufizuara).	Ndihmën ndaj të Pastrehëve	Koordinimi i veprimeve sipas nevojës; Aftësi për zgjidhjen e shpejtë dhe të drejtë të situatave konkrete.	

### Kushtet e realizimit të funksionit:

Për të kryer këtë funksion, kandidati duhet të ketë në dispozicion dhe të përdorë këto mjete: uniformën, mjetet e komunikimit, si dhe mjetet përkatëse për fëmijë, manualët për përdorim të pajisjeve, dhe pajisjet tjera relevante.

**Kërkesat e Vlerësimit:**

Test me shkrim dhe pyetje – përgjigje për të demonstruar njohuritë dhe aftësitë bazë mbi organizimin dhe menaxhimin e aktiviteteve sociale për klientët.

Kandidati i nënshtrohet provimeve praktike në një situatë reale të punës në punëtori. Vëzhgim i kandidatit nëpërmjet demonstrimit praktik të organizimit dhe menaxhimit e të aktiviteteve sociale për klientët dhe përdorimit të pajisjeve të punës.



## Funksioni 7. Siguron mbrojtje në punë dhe ruajtje të mjedisit

Ky funksion ka të bëjë me: mirëmbajtjen e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, evitim të rreziqeve, shëndetit dhe sigurisë, përdorimin e pajisjeve, veglave dhe materialeve në mënyrë të sigurt, mirëmbajtjen e pastërtisë në hapësirën e punës.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e kërkuara për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
Kontribuon në mirëmbajtjen e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës	<p>Monitoron hapësirën e punës me frekuencë të mjaftueshme për të identifikuar rreziqet potenciale për shëndetin;</p> <p>Identifikon rreziqe potenciale me saktësi;</p> <p>Ndërmerr veprime në vend për t'i parandaluar rreziqet e identifikuar;</p> <p>Raporton rreziqet potenciale qartë dhe me saktësi;</p> <p>Lëshon paralajmërime të qarta të gjithë atyre që janë në rrezik;</p> <p>Merr veprime parandaluese gjatë aktiviteteve të punës për të siguruar sigurinë e produktit të klientit.</p>	<p>Din rreziqet potenciale të shoqëruara me vargun e aktiviteteve punuese dhe mjetet për t'i zvogëluar rreziqet;</p> <p>Të njohë treguesit e rreziqeve;</p> <p>Të njohë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit për të siguruar shëndetin dhe sigurinë;</p> <p>Të njohë cilat paralajmërime, alarmime verbale dhe vizuale janë të kërkuara;</p> <p>Masat paraprake të sigurisë duke përfshirë përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale;</p> <p>Të din rëndësinë e pastërtisë në hapësirën e punës;</p>	<p>Identifikimin e rreziqeve potenciale me saktësi;</p> <p>Përdorimin e pajisjeve, veglave dhe materialeve në mënyrë të sigurtë;</p> <p>Përdorimin e mjeteve të ndihmës së parë;</p> <p>Trajtimin e mbeturinave në mënyrë të sigurtë sipas karakteristikave të saj.</p>	<p>I përshtatshëm për punën ekipore;</p> <p>Komunikativ;</p> <p>Fleksibil;</p> <p>Tolerant;</p> <p>I arsyeshëm;</p> <p>I vetëdijshëm për punën që kryen;</p> <p>Njohja e gjuhëve të huaja.</p>
Kontribuon në evitim të rreziqeve shëndetit dhe sigurisë	<p>Identifikon rreziqet e shëndetit dhe sigurisë me saktësi dhe implementon procedurën e duhur për të frenuar rreziqet;</p> <p>Raporton njerëzit përgjegjës me shpejtësi për rreziqet, për menaxhimin e situatave;</p> <p>Përdorë mjetet mbrojtëse nëse ka nevojë gjatë kryerjes së një pune;</p> <p>Pajtohet me paralajmërimin e rreziqeve dhe shenjave paralajmëruese në lokacionet e punës.</p>	<p>Din rreziqet potenciale të shoqëruara me vargun e aktiviteteve punuese dhe mjetet për t'i zvogëluar rreziqet;</p> <p>Të njohë treguesit e rreziqeve;</p> <p>Të njohë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit për të siguruar shëndetin dhe sigurinë;</p> <p>Të njohë cilat paralajmërime, alarmime verbale dhe vizuale janë të kërkuara;</p> <p>Masat paraprake të sigurisë duke përfshirë përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale;</p> <p>Të din rëndësinë e pastërtisë në hapësirën e punës;</p>	<p>Identifikimin e rreziqeve potenciale me saktësi;</p> <p>Përdorimin e pajisjeve, veglave dhe materialeve në mënyrë të sigurtë;</p> <p>Përdorimin e mjeteve të ndihmës së parë;</p> <p>Trajtimin e mbeturinave në mënyrë të sigurtë sipas karakteristikave të saj.</p>	<p>I përshtatshëm për punën ekipore;</p> <p>Komunikativ;</p> <p>Fleksibil;</p> <p>Tolerant;</p> <p>I arsyeshëm;</p> <p>I vetëdijshëm për punën që kryen;</p> <p>Njohja e gjuhëve të huaja.</p>

<p>Përdorë pajisjet, veglat dhe materialet në mënyrë te sigurtë</p>	<p>Monitoron pajisjet , veglat dhe materialet me frekuencë të mjaftueshme për të identifikuar rreziqet në shëndet dhe siguri;</p> <p>Merr masa parandaluese te përshtatshme para përdorimit te pajisjeve, veglave dhe materialet për te mbrojtur veten dhe të tjerët;</p> <p>Kontrollon dhe konfirmon para përdorimit përshtatjen për përdorim të ndonjë pajisje, vegle dhe materiali të nevojshëm;</p> <p>Përdorë pajisjet, veglat dhe materialet në mënyrë të qëndrueshme sipas instruksioneve dhe praktika më të mira;</p> <p>Identifikon dhe raporton mungesën, dëmtimin apo mosfunksionimin e pajisjeve, veglave dhe materialeve të punës, me saktësi.</p> <p>Mirëmban pajisjet, veglat dhe materialet në atë standard, i cili i plotëson kërkesat e shëndetit dhe sigurisë.</p>	<p>Të njohë cilat materiale punuese të përdoren dhe si të përdoren në mënyrë të sigurtë;</p> <p>Si të identifikohen dhe trajtohen pajisjet, veglat dhe materialet e dëmtuara.</p>		
<p>Mirëmban pastërtinë në hapësirën e punës.</p>	<p>Mban hapësirat e punës të pastra dhe në rregull;</p> <p>Trajton mbeturinat në mënyrë të sigurt sipas karakteristikave të saj;</p> <p>Trajton dhe transporton materialet, pajisjet, veglat dhe substancat në mënyrë të sigurtë dhe i deponon ato në mënyrë të sigurt në kontejnerin e duhur dhe në hapësirat e destinuara;</p> <p>Përdorë ndonjë teshë mbrojtëse të nevojshme dhe pajisje siguroese ne mënyrë korrekte, e pastron atë pas përdorimit dhe i deponon në mënyrë të sigurtë;</p> <p>Largon mbeturinat dhe pa pastërtitë pasi që është punuar dhe i deponon ato në lokacionet e</p>			

	duhura.			
--	---------	--	--	--

**Kushtet e realizimit të funksionit:**

Mbrojtja në punë- i referohet mirëmbajtjes së sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, evitimin e rreziqeve të shëndetit dhe sigurisë, përdorimit të pajisjeve, veglave dhe materialeve në mënyrë të sigurt.

Ruajtja e mjedisit -i referohet mirëmbajtjes së pastërtisë në hapësirat e punës.

**Kërkesat e vlerësimit:**

Test me shkrim i njohurive dhe pyetje – përgjigjet për të demonstruar që nxënësi i ka kuptuar kërkesat e punës, diskutim profesional.

Vëzhgim i kandidatit nëpërmjet demonstrimit praktik se si kryhen aktivitetet, grumbullohen nëpërmjet vëzhgimit të kandidatit duke i bërë këto aktivitete (të përshkruara në funksion) në një situatë reale të punës. Kontrollimi i ambientit të punës /listë kontrolli.